

UDHËTIM NË JORDANI

Dita 1 / 14 Prill : Tiranë – Amman

Takimi me guidën rreth orës 16:00 në aeroport. Nisja nga Tirana në orën 19:00. Udhëtojmë drejt Athinës, mbërrim në orën 21:10. Marrim fluturimin për në Amman në orën 00:35.

Dita 2 / 15 Prill : Mbërritja në Amman – Vizita në Jerash – Amman

Pas mbërritjes në Aeroportin e Ammanit në orën 02:45, partneri ynë na mirëpret për të siguruar një transferim të rehatshëm drejt Amman-it, kryeqytetit historik të Jordanisë. Akomodohemi në hotel me early check-in dhe çlodhemi për të rifilluar ditën.

Rreth orës 12 të mesditës do të udhëtojmë drejt **Jerash-it**, i njohur si “**Pompei i Lindjes**”. Ky qytet i lashtë greko-romak ruan arkitekturën e jashtëzakonshme, përfshirë Rrugën me Shtylla, Tempullin e Artemisit dhe Amfiteatrin Romak, ku ende organizohen shfaqje artistike. Gjatë vizitës, do të ndjejmë ritmin dhe gjallërinë e këtij vendi unik, sidomos tani në pranverë, kur kodrat përreth janë të mbushura me gjelbërim. Pas një dite të pasur me histori dhe kulturë, kthehemi në **Amman**.

Kthehemi në hotel për të konsumuar darkën. Fjetja në **Days Inn Hotel**.

Dita 3 / 16 Prill : Amman – Mali Nebo – Petra

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Dita fillon me një vizitë në **Malin Nebo**, një vend biblik me një rëndësi të madhe shpirtërore. Nga maja e malit, pamjet panoramike përfshijnë **Detin e Vdekur**, **Jerichon** dhe **Luginën e Jordanisë**, duke ofruar një eksperiencë frymëzuese. Mozaikët e mrekullueshëm dhe reliket e kishave të lashta në këtë vend tregojnë për historinë e pasur fetare dhe kulturore. Pas kësaj vizite të veçantë, udhëtojmë drejt **Petra-s**, qyteti i gdhendur në shkëmb dhe një nga Shtatë Mrekullitë e Reja të Botës. Këtu do të relaksohemi pas udhëtimit dhe do të përgatitemi për eksplorimin e jashtëzakonshëm të ditës së tretë.

Kthehemi në hotel për të konsumuar darkën. Fjetja në **Petra Canyon Hotel**.

Dita 4 / 17 Prill : Vizitë e plotë në Petra – Wadi Rum

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel.

Dita e tretë është e dedikuar plotësisht për eksplorimin e Petra-s, kryeqytetit të Nabateanëve dhe një prej thesarëve më të mëdhenj historik të Jordanisë. Do të kalojmë përmes kanionit spektakolar të ngushtë të quajtur **Siq**, i cili të çon në **Thesar** (Al-Khazneh), një strukturë mahnitëse dhe simboli më i njohur i qytetit.

Petra është një pasuri e arkitekturës së lashtë, me tempuj, varre dhe sisteme komplekse ujitjeje që tregojnë për qytetërimin e avancuar Nabatean. Pas një dite të mbushur me histori dhe emocion, nisemi drejt **Wadi Rum**, “**Lugina e Hënës**.” Ky peizazh shkëmbor i jashtëzakonshëm, me format e tij unike, është një nga vendet më të qeta dhe mistike të shkretëtirës. Shëtitjet nën qiellin e hapur, plot yje, dhe një darkë tradicionale beduine do ta bëjnë këtë natë të paharrueshme.

Fjetja në **Rahayeb Desert Camp**.

Dita 5 / 18 Prill : Wadi Rum Jeep Tour – Aqaba

Zgjhemi dhe konsumojmë mëngjesin në kamp.

Mëngjesin e fillojmë me një tur mahnitës me makina 4x4 nëpër peizazhet e Wadi Rum-it, ku shkëmbinjtë gjigantë dhe hapësirat e pafundme krijojnë një ndjesi lirshmërie dhe madhështie. Gjatë turit, do të vizitojmë vende të famshme si “**Shtëpia e Lawrence-it**,” një pikë historike që lidhet me revoltën arabe.

Pas këtij eksplorimi unik, udhëtojmë drejt qytetit bregdetar të **Aqaba-s**, i njohur për ujërat kristal dhe jetën e tij të gjallë tregtare. Pasdite shëtisim nëpër tregjet tradicionale për të provuar ushqimet dhe ëmbëlsirat vendase.

Shkojmë në hotel për të konsumuar darkën. Fjetja në **La Costa Hotel**.

Dita 6 / 19 Prill : Aqaba – Deti i Vdekur

Zgjhemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Pas mëngjesit, eksplorojmë qytetin e **Aqaba-s** duke vizituar **Kështjellën Osmane**, një monument historik nga shekulli i 16-të, dhe **Arab Revolt Plaza**, që përkujton Revoltën Arabe.

Pas këtij turi, udhëtojmë drejt **Detit të Vdekur**, pika më e ulët në Tokë dhe një prej mrekullive më të famshme natyrore në botë. Këtu do të shijojmë përvojën e notimit mbi ujin e kripur dhe aplikimin e baltës së tij minerale, i cila është e njohur për benefitet e saj terapeutike.

Kthehemi në hotel për të konsumuar darkën. Fjetja në **Hilton Resort Dead Sea**.

Dita 7 / 20 Prill : Deti i Vdekur – Amman – Aeroport

Zgjohehi dhe konsumojmë mëngjesin.

Në mëngjes, do të kemi kohë të lirë për të shijuar bukuritë dhe qetësinë e Detit të Vdekur. Pas mesditës, udhëtojmë drejt Amman-it për një tur historik të qytetit, duke përfshirë **Citadelën, Amfiteatrin Romak dhe Xhaminë Blu**.

Për të përfunduar udhëtimin në mënyrë të ëmbël, ndalojmë në një dyqan të famshëm për të shijuar ëmbëlsirën tradicionale “Kynefe / Kunafa”.

Transferohemi në hotel për tu qetësuar pak para se të nisemi drejt aeroportit.

Në mbrëmje, transferohemi drejt aeroportit për fluturimin kthyes, duke marrë me vete kujtime të paharrueshme nga ky udhëtim magjepsës. Nisja nga Amman në 03:55 (21 Prill).

DETAJE RRETH GUIDËS :

Guida Shqiptare : z.

Nr. Tel :

Guida Jordaneze :

Nr. Tel :

DETAJE RRETH FLUTURIMIT :

Fluturimi Shqiperi – Jordani 14 Prill 2025

Tirane (TIA) – Athine (ATH) : 19:00 – 21:10

Athine (ATH) – Amman (AMM) : 00:35 – 02:45 (15 Prill)

Fluturimi Jordani – Shqiperi 21 Prill 2025

Amman (AMM) - Athine (ATH) : 03:55 – 06:20

Athine (ATH) – Tirane (TIA) : 09:05 – 09:20

DETAJE RRETH HOTELEVE :

Days Inn Hotel/ Amman :

Adresa : Al Rabyeh OmarBin Abdulaziz St Amman JO 11195, Amman, Jordan

Nr. Tel : [+962 6 551 9011](tel:+96265519011)

Petra Canyon Hotel / Petra :

Adresa : Kings Hwy., Wadi Musa 71882, Jordan

Nr. Tel : [+962 3 215 4333](tel:+96232154333)

Rahayeb Desert Camp / Wadi Rum :

Adresa : Wadi Rum, Jordan

Nr. Tel : [+962 3 205 8557](tel:+96232058557)

La Costa Hotel / Aqaba :

Adresa : Al Nahada Street, Aqaba, Jordan

Nr. Tel : [+962 3 209 0400](tel:+96232090400)

Hilton Resort Dead Sea / Dead Sea :

Adresa : Dead Sea Rd., Sweimeh 11953, Jordan

Nr. Tel : [+962 5 349 3000](tel:+96253493000)

Në çdo rast pakujdesie apo largimi nga grupi, pa mundur të ribashkoheni, gjithmonë mund të merrni një taxi dhe t'i tregoni vendndodhjen e hotelit në bazë të qytetit ku ndodheni

DETAJE RRETH INTERNETIT / PARAVE :

Mund të blini kartë SIM në aeroport në Amman ose të bëni roaming me kartën tuaj aktive në Shqipëri. Një mënyrë tjetër është të blini një E - Sim në internet dhe ta instaloni në bazë të pajisjes tuaj celulare.

Përsa i përket parave, lekët mund ti shkëmbeni në monedhën vendase, dinarë Jordanezë (JOD) në aeroport. Më tepër përdoret USD, por monedhat kryesore të forta si USD, EURO, GBP mund të shkëmbehen lehtësisht. Guida shoqëruese do t'ju ndihmojë nëse është e nevojshme.

DETAJET E TURIT

Përfshihen në çmim :

- Fluturimi V/A me avion Tirane-Amman (1 valixhe dore deri 8kg)
- Transporti me autobuz privat gjatë të gjithë turit
- Akomodimi për 2 natë në Amman në Hotel 4*
- Akomodimi për 1 natë në Petra në Hotel 4*
- Akomodimi për 1 natë në Wadi Rum në Standard Beduin Camp (me tualet privat) & Darkë Tradicionale Beduine.
- 2 orë tur me Jeep 4X4 në Wadi Rum
- Akomodimi për 1 natë në Aqaba në Hotel 4*
- Akomodimi për 1 natë në Detin e Vdekur në Hotel 5*
- Mëngjeset dhe Darkat për të gjitha ditët me ushqim kontinental në formë Buffe
- Tarifat e hyrjes në të gjithë monumentet e përmendur
- Ujë mineral gjatë gjithë turit.
- Guida Shqiptare gjatë të gjithë vizitës
- Guida Lokale Jordaneze gjatë të gjithë vizitës
- Viza turistike Jordaneze

Nuk përfshihen në çmim :

- Drekat (12\$ / dita / person në formë buffe)
- Shpenzime personale
- Çdo aktivitet që nuk përmendet në rubrikën “Përfshihet”
- Bakshishe për shoferin dhe guidën

Politikat e Shërbimit

Rezervimi me Elite Travel Agency është i sigurt dhe i thjeshtë

PA KOSTO TË FSHEHURA

Shikoni çdo çmim të mundshëm pa tarifa rezervimi ose kosto të tjera të fshehura.

SIGURI NË TRANSAKSIONET TUAJA

Ne ndjekim standardet më të larta të protokolleve të sigurisë për t'i ofruar mysafirëve tanë siguri "online".

POLITIKAT E PRIVATËSISË

Ne interesohemi për privatësinë e të dhënave tuaja personale dhe marrim të gjitha masat për t'u siguruar që jemi duke ecur me hapin e kohës përpara i përket rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT

Rezervimi në faqen tonë është i shpejtë dhe i thjeshtë. Nëse keni kërkesa specifike, ekipi ynë i Operacioneve do të jetë gati për t'ju asistuar.

KONFIRMIMI I REZERVIMIT ME E-MAIL

Menjëherë pasi të keni kryer rezervimin, një e-mail me të gjitha detajet e rezervimit do të vijë në adresën tuaj.

PAGESA PER REZERVIMIN

Pagesa per rezervimin do te kryhet ne dy pjese: 50% e pageses do te kryhet ne momentin e rezervimit, 50% deri ne 21 dite para nisjes
Nëse dëshironi të ndryshoni specifikat e rezervimit tuaj, mund të na kontaktoni në një nga numrat e telefonit ose me e-mail.

POLITIKAT E KANCELIMEVE

Ne rast te anulimit nga klienti aplikohen penalitetet si me poshte :

40 % nese anulimi behet deri 30 dite perpara nisjes

75 % nese anulimi behet 30 deri ne 15 dite perpara nisjes 100% nese anulimi behet 14 dite perpara nisjes

Nese klienti qe kerkon te anulloje udhetimin e zevendeson rezervimin e tij me nje person tjetër, atehere politikat e anulimeve do te diksutohen sipas rastit konkret.

Anullimi do të quhet se është kryer në momentin që klienti paraqitet personalisht (ose i përfaqësuar nga një pjestar i grupit kur udhëtimi është rezervuar në grup) në njërin nga zyrat e agjencisë ose duke dërguar e-mail në adresën info@etg.al për t'u tërhequr nga marrëdhënia e krijuar me agjencinë.